

në bazë të detyrimeve që dalin nga Udhërrefyesi i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, të miratuar në mbledhjen e parë të punës pas konstituimit të këtij Komiteti, me qëllim të transparencës ndaj komunitetit që e përfaqëson, institucioneve komunale dhe opinionit për punën dhe aktivitetet e veta gjatë periudhës njëvjeçare, Komiteti publikon këtë:

R A P O R T

MBI PUNËN E KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KOMUNËN E PRISHTINËS PËR VITIN 2017

(I)

PJESA HYRËSE

Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara (më tej në tekst: Komiteti), i themeluar më 26 korrik të vitit 2016, në përbërje prej pesë anëtarëve, njohës të mirë të aftësive të kufizuara fizike, shqisore e intelektuale, i përzgjedhur sipas konkursit nga Panelli Intervistues i Kuvendit Komunal të Prishtinës, mbledhjet i mban kryesisht në Sallën e Mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Prishtinës, kurse aktivitetet tjera dhe takimet i zhvillon në terren dhe sipas rastit.

Si entitet i ri institucional dhe për herë të parë në Kosovë, rrjedhimisht edhe në Prishtinë, mbledhjet e para gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016, Komiteti ia ka kushtuar ndërtimit të visionit se cila mund të jetë fizionomia e punës së këtij Komiteti dhe funksionimit të tij, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit dhe të secilit anëtar veç e veç.

Përgjithësisht, në periudhën raportuese dhe sipas rregullativës së Kuvendit Komunal të Prishtinës, Komiteti ka mbajtur gjashtë (6) mbledhje, ka pasur më së shtatë (7) takime me përgjegjësit digasterialë të drejtorive komunale dhe të tjera, si dhe ka ndjekur një trajnim në kuadër të projektit “Më shumë përfaqësim për PAK”.

Por, me qëllim të efektshmërisë, Komiteti, në raste të caktuara, ka mbajtur edhe takime konsultative joformale, si dhe ka zhvilluar kontakte me institucione dhe me individë që ka konsideruar se mund të jenë aleatë të orientimeve të tija për të drejtat dhe mundësitë e PAK.

(II)

PJESA TEMATIKE

1. MBLEDHJET

1.1. Mbledhja e parë e Komitetit (26.01.2017)

Në këtë mbledhje, **me pjesëmarrje:** Mehreme Llumnica – Kryesuese e Komitetit, anëtarët: Ramadan Salihu, Armend Ademi, Fatime Demolli dhe Enver Hasangjekaj, Premtime Preniqi – Zyrtare për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Prishtinës, me procesmbajtësen Shyhrete Islami, u propozua dhe u miratua ky Rend i Ditës:

1. Miratimi i Ekstraktit të Procesverbalit të Mbledhjes së Tretë të Komitetit;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Udhërrëfyesit mbi Punën dhe Veprimtarinë e Komitetit;
3. Përzgjedhja dhe caktimi i prioritetëve për diskutim me njërin nga drejtorët e drejtorive të Komunës;
4. Rekomandimet dhe mbyllja e takimit.

Në mbledhje, anëtarët u njoftuan se janë katër takime të rregullta brenda vitit, dy të tjera mund të jenë të jashtëzakonshme, mirëpo, mund të organizohen edhe mbledhje të tjera, vetëm se për këto të fundit nuk paguhet medijtja. Po ashtu, këtu u ngrit dilemma se a janë detyruese për Kryetarin e Komunës dhe institucionet tjera propozimet dhe rekomandimet e Këtij Komiteti, ashtu siç qëndron në Vendimin nr. 031 - 67047, të datës 24.03.2016, të cilin vendim e posedojnë anëtarët e Komitetit dhe a është kjo në harmoni me Udhëzimin Administrativ nr. 2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komunë, ku thuhet se propozimet apo rekomandimet e këtyre komiteteve nuk janë obligative, por duhet të merren parasysh në zhvillimin e politikave komunale, për çka u kërkua që kjo çështje të dërgohet për interpretim në Zyrën Ligjore të Komunës.

Udhërrëfyesi mbi Punën dhe Veprimtarinë e Komitetit, me plotësimin dhe shtimin e nënpikës që parashtron sigurimin e mësuesve mbështetës dhe/apo asistentëve personal në shkolla dhe institucione parashkollore, u miratua njëzërit.

Ndërsa, sa i përket kërkesës me shkrim për takim me Kryetarin, z. Shpend Ahmeti, e cila është paraqitur para më së gjashtë muajve dhe ggjer më tash nuk është realizuar, pati komente të ndryshme, që nga ajo se po injorohemi si Komitet nga ana e Kryetarit të Komunës, gjer tek ajo se është bërë lëshim, që, në ditën e inaugurimit të ashensorit dhe platformës në objektin e vjetër të Komunës, nuk është insistuar për takim, pasi që kryetari ishte i pranishëm aty.

Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Prishtinës **e njoftoi Komitetin** se përfaqësuesit e OJQ “Handikos” dhe “Rarconstulling”, e kanë informuar Komunën për projektin që ka të bëjë me fillimin e një “Plani të veprimit në nivelin local për PAK”, si dhe trajnime për anëtarët e komitetit dhe drejtorët e drejtorive komunale, me të cilën ofertë është pajtuar edhe Drejtori i Drejtorisë së Administratës, Muhedin Nushi.

Rreth ndonjë hulumtimi të mundshëm apo punës në terren për raste të caktuara, që Komiteti e vlerëson të dobishme, duhen shpenzime të paktën minimale, për punë, për udhëtim, për ushqim etj. Për këtë u vendos me konsensus që të gjendet mundësia e financimit nga Administrata e Komunës apo edhe nga donator të jashtëm.

- Meqenë se takimi i parë është bërë me Drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, u vendos që, në periudhën gjer në seancën e radhës, takimi tjetër të aranzhohet me Drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtorin e Shërbimeve Publike. Temë e këtyre takimeve, veç tjerash, do të jetë edhe çështja e udhëtimit pa pagesë e PAK në Trafikun Urban, gjë kjo që shpesh po problematizohet, si dhe mundësia e publikimit të punës dhe aktiviteteve të Komitetit në Faqen Zyrtare të Internetit të Komunës.

1.2. Mbledhja e dytë e Komitetit (28.03.2017)

Përpos anëtarëve të Komitetit: Mehreme Llumnica – Kryesuese, anëtarë: Ramadan Salihu, Armend Ademi, Fatime Demolli dhe Enver Hasangjekaj, Premtime Preniqi – Zyrtare për të Drejtat e Njeriut, Shyhrete Islami – procesmbajtëse, në mbledhje **ishin** të pranishëm edhe: Arben Vitia – Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Hysen Durmishi – Drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, dhe Avni Zuka – Shef i Sektorit për Burime Njerëzore. Për këtë mbledhje u propozua dhe njëzërit u miratua ky Rend i Ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara;
2. Çështjet me prioritet për personat me aftësi të kufizuara në drejtoritë përkatëse në Komunën e Prishtinës (legjislacioni, qasja në shërbime etj.)
3. Të ndryshme.

Pas miratimit të ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes paraprake, dhe, meqë nuk pati të interesuar për pikën e tretë të rendit të ditës, u kalua në pikën e dytë, që kishte të bënte me çështjet me prioritet për PAK në drejtoritë përkatëse në Komunën e Prishtinës, me çrast, kryesuesja i njoftoi mysafirët për përbërjen e Komitetit, për detyrat dhe fushëveprimin e tij, si dhe për mundësitë e bashkëpunimit ndër-institucional me drejtoritë në lidhje me çështjet e PAK në Prishtinë. Debati ishte konstruktiv dhe i gjerë, në të cilin, përmes pyetjeve dhe kërkesave të anëtarëve të Komitetit dhe përgjigjeve të drejtorëve, u preken shumë çështje të komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunë, të cilat kërkojnë zgjidhje.

• Pyetjet dhe/apo kërkesat nga Komiteti:

- Ky Komitet ka veprimtari më të gjerë se 4+2 mbledhje në vit, por kostoja e veprimtarisë së tij nuk është aq e lartë sa të jetë ngarkesë buxhetore e Komunës;

- Masa kryesore institucionale integruese e PAK është punësimi i tyre, që aktualisht është shumë simbolik. Legjislacioni i posaçëm përkatës për këtë problematikë nuk është pengesë, veç se obligon për punësimin e PAK;

- Të shqyrtohet mundësia që, në rast kur PAK nuk ka aftësi psiko-fizike për punë, atëherë, të punësohet prindi i tij;

- Të financohen vetëm OJQ-të me status për përfitim publik e që merren me shërbime të veçanta për PAK;

- A ka rregullore dhe kritere për ndarjen e subvencioneve për PAK dhe a mund të publikohen në Faqen e Internetit të Komunës;

- Mungojnë rubrikat në Kartela Shëndetësore, si evidencë e llojit të aftësisë së kufizuar, me ç'rast, personeli mjekësor do të kishte qasje më të drejt dhe më cilësore ndaj PAK;

- A ka ndonjë mekanizëm për vlerësimin e nivelit dhe llojit të aftësive të kufizuara për fëmijët? Ka raste kur prindërit po maltrohen shumë në diagnozën përfundimtare të fëmijës, kështu në mungesë të diagnostifikimit apo kohës së gjatë të diagnostifikimit, reflekton me pasoja edhe në gjithë përfshirjen e fëmijës në IP;

- Vetëm një person është në shërbim të interpretimit për personat e shurdhër, ndërsa këta persona nuk kanë probleme tjera, ndaj dhe kërkesat e tyre janë më lehtë për tu plotësuar;

- Mungojnë shtigjet për PAK dhe fushat taktile për të verbër, mungojnë parkingjet e shenjuara për PAK dhe mirëmbajtja e tyre;

- Qendra Ditore që do të ndërtohet, a është për të gjithë PAK apo vetëm për lloje të caktuara të tyre? A është e drejtë të shkelet Vendimi i Kuvendit Komunal, pasi është votuar për ndërtimin e një Qendre Ditore për të gjithë PAK;

- Cilat janë mundësitë që edhe fëmijët në karroca të vijojnë në Institucionet Parashkollore.

• Përgjigjet e drejtorëve:

- PAK në Komunën e Prishtinës inkurajohen në punësim nën kushte të barabarta. Në këtë drejtim, Komuna, në bashkëpunim me Komitetin dhe OJQ-të nevojitet ta bëjnë identifikimin më ekzakt të pozitave, për të cilat ndoshta do të mund të sigurohej një përparësi për punësim të PAK. Si shembull i mirë: Komuna ka punësuar një të verbër në pozitën e telefonistit;
 - Legjislacioni për punësimin e PAK është një masë alternative, me të cilin, nën kushte të barabarta, i jepet përparësi PAK. Komuna ka kërkuar që, përveç telefonistit, që është punësuar vitin e kaluar, ta punësojë në kuadër të Njësisë për të Drejtat e Njeriut, një Zyrtar për të Drejtat e PAK, por niveli qendror nuk ka lejuar për shkaqe buxhetore;
- Mirëpo, punësimi nën kushte të barabarta, pa sanksionuar me ligj ndonjë poen përparësie mund të jetë subjektive, si për PAK ashtu edhe për prindërit e tyre;
- Për subvencione, ka pasur rregullore më heret, por është ndryshuar në vitin 2014. Në rregulloren e re, për shërbimet shëndetësore është futur faktori social dhe faktori për PAK. Nuk është në Faqe të Internetit për arsye se së bashku me DEMOS-in Komuna është duke hartuar një rregullore të re për subvencione, në përpjekje të përmbushjes së standarteve më të larta të një rregulloreje për ndarjen e këtyre subvencioneve; Është në Zyrën Ligjore të Komunës për harmonizim drafti i një marrëveshjeje për qira të objekteve të OJQ-ve si subvencione. Problem i madh këtu është mungesa e Ligjit për Prishtinën, si dhe Ligji i Prokurimit është në kundërshti me Ligjin e Shëndetësisë, gjë që mungojnë mekanizmat e konkurrencës. Kështu, subvencionimi i OJQ-ve nuk është i drejtë, nga se njëjtë subvencionohet një OJQ me një numër të vogël të shërbimeve me një organizatë me numër më të madh të shërbimeve; Çështja e Kartelave Shëndetësore është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë;

Në Qendër të Mjekësisë Familjare është një interpret për të shurdhër, por, është e nevojshme të rritet numri i tyre, mirëpo, niveli qendror nuk po lejon pranimin e punëtorëve të rinj. Po ashtu, të njëjtat kufizime janë edhe për punësimin e pediatërve, psikiatërve, etj;

- Ekipi Vlerësues i PAK ekziston, por nuk është funksional;

Është evidente mungesa e barrërave në Listën Esenciale, sidomos të materialit për dekubit dhe inkontinencë. Lista është shumë e mangët – vetëm me pak barna, si: paracet, etj;

- Vetëm një shteg për PAK është në qendër, por do të ndërtohen edhe tjerë në të ardhmen. Çështja e parkingjeve të shenjëzuara për PAK pritet të rregullohet me jetësimin e “Prishtina Park”. Shumë çështje do të zgjidhen kur të bëhet Ligji për Kryeqytetin. Por, kanë filluar së ndërtuari në Zonën Qendrore pjerrinat, në institucionet publike janë vendosur liftet, pjerrinat etj;

Qendra Ditore ka qenë e planifikuar me vite, por tash ka filluar iniciativa për Qendrën e Autizmit dhe Sindron Daun, ndërtimi i së cilës kushton 400.000 €. Komuna nuk i ka mundësitë e veta, kështu që, në bashkëpunim me dy OJQ-të, me një donacion të mbledhur të tyre, do të ndërtohet. Për këtë, Komuna ka përcaktuar një parcelë prej 22 ari tek Stacioni i Autobusëve. Në këtë qendër do të ofrohen edhe shërbime, kontrolla mjekësore për qytetarë tjerë me aftësi të kufizuara, kurse qendrimi ditore është vetëm për personat me autizëm dhe me sindron daun. Është hera e parë që po ndërtohet një qendër e tillë dhe është

mirë që kjo qendër të menaxhohet nga Komuna, për të qenë e qëndrueshme e mos të varet prej projekteve;

- **Nga këtu** mund të vijnë në drejtoritë përkatëse kërkesat për problematika të caktuara dhe të shqyrtohen pastaj mundësitë për realizimin e tyre, si për pjerrinat, për të cilat nuk kërkohen shumë shpenzime. Kërkesa të ngjashme kanë parashtruar drejtorët e shkollave dhe çerdheve, të cilat janë marrë me prioritet dhe është filluar me investimet;
- Sa i përket informimit për mundësinë e punësimit, secili konkurs i Komunës publikohet në dy gazeta ditore dhe në Faqen e Internetit të Komunës. Gjithashtu, administrata komunale mund t'ua distribuojë anëtarëve të Komitetit, Listën e Pozitave të Punëtorëve të Administratës Komunale, të kategorizuar nga Ministria e Pushtetit Lokal.
 - Kryesuesja e Komitetit i informoi drejtorët që së shpejti, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Komunës, OJQ-të e PAK dhe të Komitetit, fillon hartimi i Planit të Veprimit Trevjeçar për PAK.
 - Në bazë të diskutimeve, rrjedh konkluzioni që Komiteti është i përkushtuar të bashkëpunojë **ngushtë** me drejtoritë komunale, me qëllim të këmbimit të të dhënave dhe informacioneve për PAK. Ndërkohë që edhe drejtorët shprehen gatishmërinë për bashkëpunim dhe takime të shpeshta.

1.3. Mbledhja e tretë e Komitetit (24.05.2017)

Veç anëtarëve të Komitetit: Mehreme Llumnica – Kryesuese, anëtarë: Armend Ademi, Ramadan Salihu dhe Enver Hasangiekaj, Premtime Preniqi – Zyrtare për të Drejtat e Njeriut, Shyhrete Islami – procesmbajtëse, në mbledhje **ishte** e pranishme edhe Mevlude Zejnullahu – zyrtare nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm. Pas miratimit të ndryshimit në renditjen e pikave të rendit të ditës, Kryesuesja, për këtë mbledhje propozoi dhe si i tillë u miratua ky Rend Dite:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit konsultativ për PAK;
2. Diskutim rreth çështjeve prioritare me drejtorët e drejtorive të Komunës (Besart Vllahinja – Drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Ismail Kokaj – Drejtor i Drejtorisë së Financave, Genc Bashota – Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm);
3. Rekomandimet dhe mbyllja e takimit.

Në fillim të mbledhjes, Komiteti u njoftua nga Zyrtarja për të Drejtat e Njeriut e Komunës **për ndryshimin e Vendimit të Komitetit**, në të cilin, në pikën 4 të Vendimit paraprak thuhet ndër të tjera se propozimet e Komitetit janë obligative, ndërsa Vendimi i tashëm, i cili u është shpërndarë anëtarëve, shkruan ashtu siç është në Udhëzim, se propozimet nuk janë obligative, por të cilat mund të merren parasysh në zhvillimin e politikave komunale, kur janë në harmoni me vendimet e Kuvendit komunal. Kurse, sa i përket mandatit të anëtarëve të Komitetit, përkatësisht, ndërrimit të 1/3 anëtarëve me anëtarë të rinj, siç po flitet, **zyrtarja** dha sqarime se Udhëzimi Administrativ thotë ndryshe e Vendimi, në pikën 3, thotë: Mandati i anëtarëve të Komitetit, cekur në pikën 2, është trevjeçar. Ndërkaq, ndërrimi/shkarkimi i anëtarit të Komitetit, gjatë mandatit, bëhet nga Kuvendi Komunal, pas propozimit të bërë nga Kryetari i Komunës, për shkak të sjelljeve të këqija, shkeljes së rregullave dhe të ligjit. Para vendimit për shkarkim, anëtarit duhet dhënë e drejta për dëgjim, me ç'rast, ai/ajo duhet ofruar shpjegimin dhe arsyet e tij/saj. Komiteti, me propozim të Kryesuesit, ka të drejtë të kërkojë largimin e anëtarit të Komitetit, nëse tri herë

radhazi pa arsye nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e Komitetit. Propozimi për largim i ofrohet Kuvendit Komunal.

Me miratimin e ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë për këtë vit të Komitetit, u kalua në pikën e dytë të Rendit të Ditës, për të cilën ishte paraparë diskutimi rreth çështjeve prioritare për PAK, me drejtorët e drejtorive komunale: Besart Vllahinja – Drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Ismail Kokaj – Drejtor i Drejtorisë së Financave, Genc Bashota – Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, të cilët nuk kishin ardhur në mbledhje, përveç Mevlude Zejnullahu – përfaqësuese nga Drejtoria e Planifikimit Strategjike dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, të cilën Kryesuesja e informoi për përbërjen dhe detyrat e Komitetit, si dhe për mundësitë e bashkëpunimit me Drejtorinë e Planifikimit Strategjike dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, lidhur me problematikat e PAK në Prishtinë, që ndërliidhen me këtë digaster.

Debati u zhvillua në frymën e mirëkuptimit dhe premtues për rezultate konkrete, në të cilin, përmes pyetjeve dhe kërkesave të anëtarëve të Komitetit dhe përgjigjjeve të përfaqësuesës nga drejtoria gjegjëse, u gjetën shumë pika, në të cilat, bashkëpunimi mund të jetë i frytshëm në të ardhmen për PAK.

• Pyetjet dhe/apo kërkesat nga Komiteti:

- Drejtoria e Planifikimit Strategjike dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm do të kishte pasur rol shumë të rëndësishëm nëse në strategjinë dhe planifikimin e zhvillimit do ta përfshinte edhe çështjen e PAK, sidomos tek qëndrueshmëria në atë pjesën e anës financiare, fondeve, subvencioneve në planifikim, në bazë të legjislacioneve dhe rregulloreve që ka;

- Gjatë hartimit apo ndryshimit të rregulloreve, që kanë të bëjnë me PAK, të marrë pjesë edhe një përfaqësues nga Komiteti. Kjo, në mënyrë që të mënjanohej paqartësitë eventuale, si në takimin e kaluar, ku drejtorët nuk shihnin mundësi konkrete për punësimin me përparësi të PAK as në Ligjin e Punës, as në atë të Shërbyesve Civil, siç edhe kishte ndalesa për konkurse të veçanta për punësimin e këtyre personave në mënyrë afirmative. Megjithëse, **në Komitet mbizotëron mendimi se këto ligje dhe Ligji për Aftësimin Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e PAK, nuk e pengojnë njëri-tjetrin;**

- Cilat mund të jenë kriteret stimuluese për bizneset në Qendrën e Bizneseve, për punësimin e PAK;

- Kuota 1 PAK në 50 të punësuar është nganjëherë edhe kuotë penguese, sepse ka shumë biznese të suksesshme që nuk i kanë 50 të punësuar;

- Nëse ka mundësi që, para se të shpallet ndonjë konkurs i kësaj natyre, të njoftohet Komiteti, në mënyrë që me kohë të njoftohen OJQ-të për përgatitje të aplikimit të PAK;

- **Sa i përket** përgatitjes shkollore, PAK ka pothuajse të të gjitha profileve, me shkollë fillore, me shkollë të mesme/profesionale, me fakultet, me master, kështu që lirisht mund të thuhet se i përmbushin kriteret;

- **Por**, kur fillon faza e implementimit të këtyre projekteve, dhe, në kuadër të drejtorisë, a ka ndonjë projekt konkret për PAK, përpos këtyre dy iniciativave;

- Trajnime për hoteleri dhe për informatikë janë të kërkueshme dhe të nevojshme. Por, a ka staf dhe ambiente adekuate, sepse në shoqata janë organizuar trajnime të tilla, por, komuniteti i të verbërve ka nevojë për trajnim në informatikë më të avancuar, **për ç’gjë nuk duhet asgjë e veçantë – programet foljore për të verbër mund të zbriten nga internet apo të barten me USB;**

- Është një eksperiencë e mirë rreth trajnimeve në Qendrën e Aftësimeve Profesionale, gjatë të cilave, u është paguar PAK ushqimi dhe transporti. Një praktikë e tillë do të duhej të ndiqej edhe në këtë rast, sepse ata i kanë këto dy problem në rast të vijimit të trajnimeve;
- **Si Komitet**, na janë dhënë nga Administrata e Komunës, listat me të dhëna se në cilat drejtori mund t'i kyçim PAK. Ne i selektojmë këto pozicione, në të cilat ka mundësi t'i kyçim PAK dhe këto analiza ia kthejmë administratës. Në bazë të këtyre të dhënave, vetëm trre PAK ishin të punësuar. Në parim, ka vend edhe për nëntë PAK dhe ka mundësi ligjore të hapet ndonjë vend pune në këtë kuadër. Por ky numër i referohet vetëm personelit të Komunës, ndërsa mungojnë të dhënat për QMF-të dhe për arsimin, gjë që mbetet detyrë e Komitetit t'i vizitojë ato dy drejtorate, me qëllim të kompletimit të të dhënave. Në bashkëpunim me OJQ-të i plotësojmë këto të dhëna, për të ditur se kush është aktualisht adekuat për një vend të caktuar pune;
- **Punësimi i PAK nga komuniteti i autizmit është specifik**, sepse ky nocion u referohet vetëm fëmijëve. Në Prishtinë nuk njihet dikush nga ky komunitet që i ka kaluar 20 vjet, sepse autizmi është njohur vonë si term i aftësisë së kufizuar dhe këtu ende nuk ka trajtim adekuat shëndetësor;
 - Të ketë një evidencë edhe për prindërit e papunësuar të PAK me autizëm, në mënyrë që të kenë mbështetjen e Komitetit, në rastet e konkurimit.

• **Përgjigjet e Përfaqësueses së Drejtorisë së Planifikimit Strategjike dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm:**

- Drejtoria e Planifikimit Strategjike dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm përfshin disa projekte të mëdha, të cilat prekin drejtpërsëdrejti jetën e qytetarëve. Është në finalizim e sipër një Qendër, e cila do t'u ipet në shfrytëzim bizneseve të caktuara dhe si qëllim do ta ketë punësimin e qytetarëve, kështu që do të konsultohemi në drejtori për mundësinë që atyre bizneseve t'u lihet një hapësirë, brenda së cilës, të ketë vend edhe për PAK. Janë duke u finalizuar edhe kriteret. Ajo hapësirë do të jetë pa pagesë, me kusht të punësimit të qytetarëve të Prishtinës, e në kuadër të kësaj, edhe PAK. Kjo hapësirë konkretisht është në rrugën për Gërmë, aty ku ka qenë Shkolla Politike. Qëllimi është që bizneset të vijnë e të forcohen dhe, në momentin që rriten, t'ua lëshojnë radhën bizneseve të reja. Me rendësi është të punësohen PAK në këtë rast. PAK do të aftësohet dhe mund të mbesë më gjatë në punë. Sa për fillim, mjafton që pas një kontrate, PAK do ta ketë një referencë pune;
- **Duhet shikuar se çfarë biznesesh ofrohen**, a kanë nevojë ato për profilet që i kanë PAK, si dhe a munden PAK t'i përmbushin kriteret e kërkuara nga bizneset;
- Në kuadër të drejtorisë është Qendra për Zhvillim dhe Karrierë, dhe edhe këtu mund të bëhet diçka. Mund ta organizojmë një trajnim, që do t'u ndihmonte për punë të rinjve PAK. Për këtë, ne duhet të punojmë bashkërisht e t'i sigurojmë të dhënat se çfarë profilesh apo shkollash kanë PAK;
- **Projekti biznesor** ka qenë planifikuar të fillojë në mars të këtij viti, por ka ngecje në aspektin ligjor. Nuk kemi përvojë të këtillë se si të ipen në shfrytëzim, për shkak se nuk njohim një praktikë të ngjashme. Mirëpo, kur të vije tek inaugurimi, do ta ftojme Komitetin. Do ta keni rastin t'i kontaktoni pronarët e bizneseve, që mund të ketë rezultate konkrete;
- **Tash për tash**, është duke u punuar me shkolla të mesme profesionale (për kuzhinier), të vitit të tretë dhe të katërt. Nëse jeni të interesuar, e kishim caktuar një trajner për një program të veçantë, që ju e kishit parë të arsyeshme;
- **Do të shikohen mundësitë për transportin dhe ushqimin gjatë trajnimeve.**
 - pika e tretë e Rendit të Ditës, dhe me këtë e tërë mbledhja, përfundoi me zotimin e Përfaqësueses së Drejtorisë së Planifikimit Strategjike dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm se të gjitha këto çështje që u përmenden këtu, drejtoria e saj do t'i ketë në konsideratë dhe për të gjitha Komiteti do të jetë i informuar. Gjithashtu, nisur nga diskutimet, mund të konkludohet se Komiteti është i gatshëm të bashkëpunojë **ngushtë** me Drejtorinë e Planifikimit Strategjike dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, konkretisht me

përfaqësuesen e kësaj drejtorie, me qëllim të ideve dhe mundësive për përkrahje të çështjes së PAK dhe të obligimeve ndaj tyre.

Gjer në mbledhjen e radhës, u konkretizuan hapat që duhet ndërmarrë si Komitet, për jetësimin e gjithë asaj që u dakordua në mbledhje, e ata janë:

- **Të kontaktohet me zyrtarin përgjegjës në DKA, rreth informimit mbi të dhënat e të punësuarve në atë drejtori dhe sa PAK të punësuar janë aty;**
- Të përgatiten pasqyrat nga OJQ-të mbi numrin e të papunësuarve PAK dhe kualifikimin e tyre.**

1.4. Mbledhja e katërt e Komitetit (19.07.2017)

Presentë në këtë mbledhje të Komitetit ishin: Mehreme Llumnica – Kryesuese, anëtarë: Fatime Demolli, Armend Ademi dhe Ramadan Salihu, Premtime Preniqi – Zyrtare për të Drejtat e Njeriut, Shyhrete Islami – procesmbajtëse. Mysafir në mbledhje ishte Rustem Gashi – Fondacioni për Shoqëritë Civile “KCFS”.
Për këtë mbledhje u propozua dhe u miratua Rendi i Ditës, me këto pika:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit;
2. Bashkëpunimi dhe koordinimi në mes OPAK dhe Komitetit, hap në fuqizimin e Komitetit;
3. Konkretizimi i iniciativave të përbashkëta në mes drejtorive komunale dhe Komitetit;
4. Të ndryshme.

Me miratimin e Ekstraktit të Procesverbalit të Mbledhjes së Tretë të Komitetit, pasi që nuk kishte ardhur askush nga drejtoritë komunale për të debatuar rreth konkretizimit të iniciativave të përbashkëta me Komitetin, si dhe meqë nuk pati interesim për pikën e katërt – Të ndryshme, diskutimi kryesisht u zhvillua rreth pikës së dytë të Rendit të Ditës – Bashkëpunimi dhe koordinimi në mes OPAK dhe Komitetit, hap në fuqizimin e Komitetit.

• **Mehreme Llumnica**, veç tjerash, tha se si Komitet i përfaqësojmë të gjitha kategoritë e aftësive të kufizuara dhe në Udhërrefyesin e dalë nga ky Komitet, rëndësi të veçantë ka edhe bashkëpunimi me OPAK, me të cilat mund t'i koordinojmë dhe drejtojmë problematikat e identifikuar të PAK, i cili koordinim në mes të organizatave dhe Komitetit ende nuk është në nivelin e duhur. E në mungesë të këtij bashkëpunimi, po hasim në vështirësi edhe në iniciativat e ndërmarra si Komitet. Konkretisht, po ngecim në kompletimin e të dhënave, të listës së anëtarëve për punësim, për çka jemi zotuar në takimet me Shefin e Burimeve Njerëzore të Komunës dhe me Përfaqësuesen e Drejtorisë së Planifikimit Strategjike dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në këto takime të rregullta të Komitetit dhe në një punëtori të organizuar nga HANDIKOS, në kuadër të projektit “Finalizimi i nevojave dhe prioritetëve të PAK në Komunën e Prishtinës”, kemi marrë informacione të rëndësishme, në lidhje me atë se çka ka bërë dhe çka mund të bëjë Komuna, si dhe çka mund të bëjmë ne bashkërisht, me ç'rast, kemi identifikuar edhe probleme tjera të PAK, për të cilat nuk kemi qenë më parë në dijeni.

Ajo kërkoi sërish nga Armend Ademi dhe nga Fatime Demolli, që t'i sjellin të dhënat për punëkërkesit nga komuniteti i të shurdhërve, përkatësisht nga komuniteti i Sindrom Daun, në mungesë të të cilave, nuk ka qenë e mundur të dërgohen të dhënat tek Përfaqësuesja e Drejtorisë së Planifikimit Strategjike dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, si dhe tek Shefi i Burimeve njerëzore në Komunë. Disa pozita, në të cilat mund të punojnë PAK, janë: në administratë – si asistent administrativ, në Zyrën për të Drejtat e Njeriut –

Zyrtar për PAK, në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – një përfaqësues i aftësisë së kufizuar fizike.

- Fatime Demolli kërkoi falje lidhur me thirrjet që i janë bërë e nuk është përgjigjur. Tha se ka qenë në pushim mjekësor, gjegjësisht, me fëmiun e sëmurë në spital. Ajo u shpreh se pozita e saj e punës në Institucion Parashkollor është më specifike. Kështu që mund të ndodhë që nuk mund të jetë prezente në çdo takim apo trajnim, që mbahen në kuadër të Komitetit.

Megjithatë, përkundër mospranisë në Komitet, Fatimja i renditi disa aktivitete që i ka ndërmarrë ajo vetë dhe tha: Unë kam bashkëpunuar në këtë interval me Drejtoreshën e DKA dhe, si rezultat i kësaj, është miratuar kërkesa e bërë në emër të Komitetit, për t'i liruar automatikisht fëmijët PAK nga pagesa për qëndrim në qerdhe dhe pa procedura të shumta administrative, si fëmijët tjerë, gjë kjo që nuk ka qenë gjer më tash. Po ashtu, në takimin që kemi pasur me Shefin e Personelit të Komunës, e kam marrë përgjegjësinë që të angazhohem personalisht për ndryshimin e aplikacionit për punësim të personelit arsimor. Në pamundësi për tu takuar, i kam shkruar emailin dhe më është përgjigjur pozitivisht. Aplikacioni është ndryshuar, ashtu siç kemi kërkuar, duke e vënë në fillim të tij rubrikën “A jeni PAK”. Javën tjetër do të publikohet konkursi për mësimdhënës dhe shfrytëzoi rastin që nga këtu që t'i inkuraroj punëkërkuesit PAK të aplikojnë.

- **Duke mos u pajtuar me një pjesë të arsytimit të Fatime Demollit**, Mehreme Llumnica tha se kur jemi pranuar me konkurs, të gjithë e kemi ditur se nuk kemi pagesë të rregulltë, se kemi për të pasur kohë pas kohe angazhime, se është Komitet fillestar dhe, përveç takimeve të rregullta, do të kemi edhe takime me zyrtarë të ndryshëm dhe trajnime të ndryshme. Tha se nëse e kemi synim hartimin e Planit të Veprimit, pa grup punues nuk mund të bëhet një punë e mirëfilltë.

- **Ramadan Salihu** u shpreh se, përkundër përvojës shumëvjeçare në OJQ, e ka pasur vështirë ta konceptojë se cili është roli i Komitetit, krahas ekzistimit të OJQ-ve komunitare. Mirëpo, brenda periudhës njëvjeçare, që nga konstituimi i Komitetit, është punuar mjaft dhe me përgjegjësi. Sa i përket bashkëpunimit me OJQ-të, Komiteti nuk mund të bëjë asgjë pa to, edhe pse ka shumë vërejtje në punën e tyre. Gjithsesi, bashkëpunimi ynë me OJQ-të duhet të jetë i dyanshëm, gjë kjo që ende nuk ka ndodhur. Ne duhet t'i vizitojmë ata, sipas një programi të caktuar, dhe ata do të duhej ta njohin Komitetin si hallkë kryesore e ndërlihdhjes me Komunë. Është e dobishme që kërkesat apo propozimet e tyre të vijnë e të shqyrtohen më parë nga Komiteti e pastaj të kalohen në institucione dhe jo drejtpërdrejtë, sepse, si organ këshillëdhënës, në raste të caktuara, po ato institucione do ta kërkojnë mendimin tonë.

Sa i përket punësimit, lypset përqendruar në punësimin ligjor e jo humanitar të PAK. Këto lista që janë përpiluar, duhet të plotësohen edhe prej Sindrom Daun dhe nga të shurdhërit, pastaj ne bashkërisht do ta kishim përpiluar listën unike me të dhëna konkrete.

E në lidhje me trajnimet, ato janë të parëndësishme, sikurse edhe Plani i Veprimit. Ligji është ai që i përcakton të drejtat dhe benifitet e PAK. Ajo çka mundemi është të insistojmë në zbatimin e legjislacionit, i cili ka ngecje evidente. Ndërsa, në raste kur gjejmë mangësi në legjislacion, atëherë duhet të iniciojmë përmirësimin e tij. Interesi i Komitetit është ngritja e cilësisë dhe e kapaciteteve të veta në raport me entitetet homologe.

- Duke mos u pajtuar me një pjesë të konstatimit të **Ramadan Salihut**, Mehreme Llumnica tha se punëtoritë i konsideron shumë të rëndësishme, ngase aty kemi marrë informacione, të cilat nuk i kemi ditur, se çka mund të bëjë dhe çka punon në lidhje me aftësinë e kufizuar Komuna, çka mund të bëjmë dhe çka jemi duke bërë ne. Ka keqinterpretime rreth punës së OJQ-ve ose ne i kemi keqinterpretuar apo

nuk i kemi ditur mundësitë ligjore as buxhetore të Komunës, çka dhe deri ku mundemi të kërkojmë, si dhe në ç' drejtim mund të bashkëpunojmë.

- Premtime Preniqi u inkuadrua rreth çështjes së trajnimit që bëhet për Planin e Veprimit dhe mendon se ky plan është i mirëseardhur. Komuna e Prishtinës e ka pasur edhe para disa viteve një plan, i cili nuk është miratuar në Kuvend. E çdo proces i ri që fillon, duhet ta ketë një plan.

- **Treth planit**, Ramadan Salihu shtoi se edhe nëse miratohet Plani i Veprimit për PAK, punësimi i tyre nga Komuna gjithmonë ka për tu bërë sipas Ligjit të Shërbyesve Civil, sipas Ligjit të Punës, sipas Ligjit për Aftësimin Ri aftësimin Profesional dhe Punësimin e PAK, ose sipas ndonjë ligji tjetër përkatës. Por, punësimi i PAK, në këtë rast, s'ka për tu bërë me një Plan të Veprimit të tillë, sepse me asnjë plan apo normë tjetër juridike nuk mund të ketë punësim jashta dispozitave të përcaktuara ligjore. Sa humbim kohë rreth këtyre planeve, ne duhet, në bashkëpunim edhe me mekanizmat tjerë kontrollues të administratës, si dhe me shoqërinë civile, të kërkojmë fuqishëm dhe konkretisht zbatimin e ligjshmërisë. E ku ka mangësi ligjore, të iniciojmë përmirësimin e kuadrit ligjor. PAK i kanë të sanksionuara të drejtat e veta me ligje dhe vetëm fuqia e zbatimit të ligjit mund të çojë tek realizimi i atyre të drejtave.

- Premtime Preniqi tha se çdo ligj i ka edhe nënligjet apo aktet e veta nënligjore dhe ne si nivel komunal krijojmë rregullore, duke u bazuar në ligj, sepse ligji është më përfshirës dhe shkojmë me një nivel më të ulët dhe e adaptojmë për nevojat tona. Ne jemi në fazën e planit të veprimit dhe plani i veprimit nuk del asgjë jashtë ligjit, vetëm e zërthen mënyrën si të realizohet ky ligj edhe në faza të tjera. Secila komunë e ka rregullimin e brendshëm, në të cilin mund ta zbatojë këtë plan.

- Mehreme Llumnica vazhdoi se edhe Plani i Veprimit është një rrëfyese, është një shtytës. Ajo tha se Drejtoria e Planifikimit Strategjike dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, është duke e bërë planin për t'u dhënë bizneseve të vogla parcela falas, nëse punësojnë PAK dhe ne ende s'i kemi dërguar të dhënat. Andaj, t'i sigurojmë të dhënat nga OJQ-të, që të mos vonohemi. Kështu që, edhe nëse asgjë nuk vepron Komuna, nuk mund të gjejmë arsye se nuk i kemi dërguar të dhënat me kohë. Dhe ne arsyetohemi se i kemi pasur të dhënat, por nuk kemi dashur edhe përkundër premtimeve. Drejtori i Shërbimeve Publike ka shprehur gatishmërinë t'i pranojë disa praktikantë PAK. Ideja ka qenë t'i dërgojmë tre persona, mirëpo ata janë punësuar me iniciativën e HANDIKOS-it. Ndërsa, prej OJQ-ve tjera, nuk ka pasur interesim për praktikë. Pozicionet i kemi selektuar në këtë mënyrë: Shoqata e të Verbërve, nëse i ofrohet mundësia e sinkronizimit, mund të punojnë si asistentë administrative; Shoqata HANDIKOS ka shumë persona që kanë qenë në trajnime shtesë për asistentë administrativ, por mund të punojnë edhe në arkivë, zyrtarë të certifikatave; personat me Sindrom Daun dhe me dëmtime intelektuale, me shkollim të mesëm, mund të punojnë në fotokopje, etj.

- Ramadan Salihu tha se PAK mund ta kryejnë secilin profesion për të cilin janë aftësuar.

- Fatime Demolli tha se për personat me Sindrom Daun është më problem që të selektohen. I kam bërë kërkesë Kryetares së Shoqatës "Sindrom Daun", që deri të premtën t'i dërgojë të dhënat dhe nëse nuk i dërgon, Komiteti mund të shkojë me këto të dhëna që i ka.

- Armend Ademi tha se ai, sikurse edhe shumë të shurdhër, ka patent-shofer, ndaj dhe i shurdhëri mund të punojë shofer. Interpretuesi nuk i duhet gjithëherë të shurdhërit, vetëm kur ka takime dhe intervista, prandaj personat e shurdhër mund të punojnë edhe në arkivë, si asistentë administrativ, si postierë, si mirëmbajtës teknik (shtëpiakë), etj.

- Fatime Demolli ceku edhe njëherë se Drejtoria e Arsimit, në javën e ardhshme, do të shpallë konkurs për arsimin, kështu që secili mund t'i shohë pozitën e anëtarëve të komuniteteve të veta, në të cilat mund të përshtaten, se do të ketë mësimdhënës, shoferë, teknikë, roje, etj.

- Armend Ademi kërkoi që të informohen kur të hapet konkursi, gjë këtë që e mori përsipër Fatime Demolli.

- Mehreme Llumnica e pyeti Premtimen se a ka Komuna e Prishtinës ndonjë plan ose rregullore lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, e cila iu përgjigj se është formuar grupi punues për hartimin e Rregullores për mbrojtjen e fëmijëve në përgjithësi.

Mbledhja përfundoi me konkluzionet që:

- Të përpunohet dhe finalizohet lista e punëkërkesve PAK, me autorësinë dhe monitorimin e Komitetit;
- Të realizohen vizita institucionale, me qëllim të sensibilizimit të çështjes së aftësisë së kufizuar;
- Të vijohen punëtoritë dhe trajnimet, me qëllim të rritjes së kapaciteteve njohëse dhe informuese të Komitetit.

1.5. Mbledhja e pestë e Komitetit (19.09.2017)

Të pranishëm në mbledhjen e pestë të Komitetit ishin: Mehreme Llumnica – Kryesuese, anëtarë: Enver Hasangjekaj, Fatime Demolli, Armend Ademi dhe Ramadan Salihu, Premtime Preniqi – Zyrtare për të Drejtat e Njeriut, Shyhrete Islami – procesmbajtëse. Mysafir në mbledhje ishte Arbena Dakaj – përfaqësuese nga KCSF. Rendi i Ditës, i propozuar dhe i miratuar për këtë mbledhje, ka për shqyrtim këto pika:

1. Miratimi i Ekstraktit të Procesverbalit të mbledhjes së Katërt të Komitetit;
2. Puna e deritashme, sfidat, si dhe rezultatet e Komitetit;
3. Konkretizimi i iniciativave të ndërmarra dhe iniciativat e reja;
4. Të ndryshme.

Para se të fillohet me pikat e rendit të ditës, Mehreme Llumnica, kryesuese, informoi se planifikojnë organizimin e një tryeze të rrumbullakët për punëtoritë që janë zhvilluar lidhur me Planin e Veprimit. Në këtë takim janë ftuar të marrin pjesë: kryetari i Komunës, përfaqësues të drejtorive, anëtarët e Komitetit dhe grupi punues. Mendoj që nga Komiteti, si njohës i ligjeve, në grupin punues të jetë Ramadan Salihu, nëse edhe ju pajtoheni.

Pasi që ky propozim dhe Ekstrakti i Procesverbalit të mbledhjes paraprahe u miratua njëzërit, debate u hap rreth pikës së dytë, që ka të bëjë me punën e deritashme, sfidat dhe rezultatet e Komitetit.

- **E para** Mehreme Llumnica filloi me atë se s’mund ta thotë një përmbledhje të plotë, por disa hapa janë parë sa i përket kësaj pike, të cilat kanë dhënë rezultate, së paku, çdo sektor i Komunës është më i sensibilizuar për çështjen e PAK. Sigurisht që në këtë kanë ndikuar takimet e rregullta, punëtoritë dhe dy projektet që janë në realizim me Komitetin dhe me Planin e Veprimit. Me rëndësi është që tash dihet se është një mekanizëm në të cilin mund t’i adresojmë çështjet e përbashkëta të të gjitha OJQ-ve të aftësisë së kufizuar.

Sa i përket punësimit, është marrë një iniciativë e përbashkët mes AKRC, Komitetit, Handikosit dhe Klubit “Dëshira”, për ta bërë një hulumtim se sa është duke u respektuar punësimi nëpër sektorët public komunal të Prishtinës. Fatkeqësisht, vetëm 13 PAK janë të punësuar në stafin e Komunës. Handikosi është në biseda për një marrëveshje me Drejtorin e Trafikut Urban, për t’i liruar nga pagesa e udhëtimit PAK. Ata kanë kërkuar dokumente valide për t’u identifikuar lloji i aftësisë së kufizuar. Nuk kam

informacion se a kanë ndonjë lloj karteletë të shurdhërit dhe të Sindron Down-it. Siç ka thënë drejtori, që nga viti 2014, është vendimi i publikuar nëpër autobusë të Trafikut Urban se lirohen fëmijët gjer në moshën 7 vjeç dhe PAK. Në marrëveshjen, e cila është në përpilim e sipër, do të kërkojmë të ceken llojet e aftësisë së kufizuar. Trafiku Urban del se po e respekton ligjin, ngase, nga 150 punëtorë, 3 i kishin PAK. Në planin që e kishin për punësimin edhe të 150 punëtorëve tjerë, do të ketë edhe PAK. Ajo bëri të ditur se është duke u hartuar një rregullore në nivel komunal për mbrojtjen e fëmijëve.

- Premtime Preniqi lidhur me këtë rregullore, ceku se kjo është një rregullore e brendshme dhe është e drejtë e çdo komune ta ketë një rregullore për të drejtat e fëmijëve. Është i formuar grupi punues dhe është i përfaqësuar prej nivelit komunal. Për të qenë kjo rregullore gjithëpërfshirëse, në takimin e parë janë të ftuara institucionet vendore dhe ndërkombëtare që merren me këtë çështje, për të marrë informata dhe për të ndihmuar në hartimin e saj.

- Fatime Demolli pyeti se takimi me drejtorin e Trafikut Urban a është zhvilluar në kuadër të Komitetit, apo në kuadër të Hendikosit, **si dhe** a mundemi edhe ne si Komitet t'ju ndihmojmë për t'i përfshirë të gjithë PAK.

- Mehreme Llumnica u përgjegj se kjo ka qenë në kuadër të Handikosit. Mirëpo, e kam ngritur këtë çështje për të diskutuar edhe me juve, me qëllim të përfshirjes edhe të aftësive tjera të kufizuara. Ai vendim i Trafikut Urban, që ishte në fuqi prej vitit 2014, besoj se vlen për të gjitha aftësitë e kufizuara.

- Premtime Preniqi tha se edhe nëse vlen ai vendim për të gjitha aftësitë e kufizuara, ju si Komitet mund ta bëni një shkresë për Trafikun Urban.

- Mehreme Llumnica njoftoi se Kompania “Al Trade” ka ofruar bashkëpunim në të ardhmen në sferën e edukimit. E kanë hapur edhe Shkollën Profesionale “Bau Academy” dhe do të pranojnë nxënës, 50% të cilëve do të kenë bursa. PAK do të kenë përparësi për bursa në atë Shkollë Profesionale. Janë profile që i kërkon tregu i punës. “Al Trade” është kompani e madhe. Ajo ofron mundësi pune në radhet e veta dhe bën marrëveshje me shtetet perëndimore për shkëmbim të punëtorëve për punë sezonale. Është kjo një përkrahje shumë e rëndësishme nga ana e tyre. Ggjer më tash, ata kanë mbështetur SOS Fshatin e Fëmijëve, Kryqin e Kuq, etj.

Ndryshe, iniciativa e **Fatimes** ka rezultuar me sukses, sepse, në konkursin e fundit të DKA ka qenë edhe rubrika për PAK, të cilën e kemi kërkuar si Komitet. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe një PAK.

- Armend Ademi **pyeti se** a është i shkruar vendimi për lirimin e PAK, që nga viti 2014.

- Mehreme Llumnica tha se Shefi i Trafikut Urban ka deklaruar se vendimi është i vendosur nëpër autobusë. Edhe vetë e ka parë të vendosur në autobus, ku shkruan: Personat hendikep dhe fëmijët nën moshën 7 vjeç lirohen nga pagesa e biletës. Mirëpo, termi “hendikep” ka qenë i paqartë për qytetarë dhe për punëtorët e Trafikut Urban.

- Armend Ademi tha se ka qenë në Ndërmarrjen “Trafiku Urban” dhe ka marrë përgjigje se nuk ka ndonjë vendim për lirim.

- Mehreme Llumnica tha se në çdo autobus të Trafikut Urban është i vendosur ky vendim.

- Fatime Demolli shprehu mendimin se do të duhej caktuar një takim si Komitet me Trafikun Urban, për të biseduar për terminologjinë, si dhe të përcaktohet ajo që secili PAK të posedojë librezë prej shoqatës respective, në mënyrë që të lirohet nga bbileta.

- Armend Ademi u shpreh i pajtimit për takim, në mënyrë që të mos kenë probleme asnjëra shoqatë dhe termi si term të përdoret si duhet.

- Enver Hasanaxhekaj, sa i përket rubrikës për PAK në aplikacion, tha se është për t'u gëzuar, sepse është hera e parë që ka hyrë në aplikacion kjo rubrikë.
- Premtime Preniqi tha se në momentin që aplikon një PAK, atëherë ai ka bazë që edhe mund të ankohet.
- Mehreme Llumnica tha se në takimin që kemi pasur me Drejtorin e Shërbimeve Publike, Armendi i ka parashtruar një pyetje lidhur me lirim në transport, nuk e kam të qartë se a do të lirohemi nga pagesa. Po ashtu pyeti se Trafiku Urban a është me Shërbimet Publike.
- Armend Ademi bëri të ditur se drejtori është përgjigjur se nuk është kompetencë e tij për të na liruar nga pagesa, ndërsa për parkingje ka thënë po çka ka nevojë.
- Premtime Preniqi tha se "Trafiku Urban" është Ndërmarrje Publike.
- Fatime Demolli pyeti për çështjen e kërkesës për takim me Kryetarin e Komunës.
- Premtime Preniqi tha se kryetari ka qenë shumë i zënë me punë.
- Mehreme Llumnica tha se kemi dërguar informacion paraprak tek kryetari dhe tek nënkryetari, mirëpo së paku të na ishin përgjigjur se nuk kanë kohë.
- Fatime Demolli shprehu mendimin se do të duhej pasur një takim, ku do të informohej se çka kemi bërë si Komitet.
- Ramadan Salihu tha se roli i Komitetit po vjen e po rritet, ashtu si edhe duhet të jetë. E kjo po bëhet ndoshta edhe për shkak të ndryshimeve në nivelin qendror, me rastin e themelimit të Forumit të Aftësisë së Kufizuar.

Sa i përket Trafikut Urban, nuk kanë pasur të drejtë ligjore as për ta publikuar atë vendim që PAK mos të lirohen nga pagesa, sepse Trafiku Urban është institucion publik dhe ai nuk mund të vendosë diçka jashtëligjore. Lirimi nga pagesa është e drejtë ligjore, andaj nuk ka nevojë as Komiteti, as OJQ—të të bëjnë marrëveshje me Trafikun Urban e as me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për t'i liruar PAK nga bileta, por vetëm duhet insistuar në zbatimin e ligjit.

Sa i përket çështjes së aplikacionit, kur ka kërkuar Fatimja një gjë të tillë, kam qenë skeptik. Mirëpo, është meritë e saj dhe e Komitetit në këtë rast, edhe për faktin se vetëm Komuna e Prishtinës e ka një këso rubrike. Megjithatë, a i jep përparësi kjo rubrikë PAK për praninë në punë. Mendoj se një pyetje e tillë vetëm mund t'ia tërheqë vëmendjen komisionit pranues, por jo edhe që obligon diçka, sepse nuk është dhe nuk mund të jetë kjo kriter formal i konkursit. Andaj, të iniciojmë që, në mënyrë të koordinuar të kompetentëve me Zyrën ligjore, të zbatohet parimi i ligjshmërisë.

Në listën e të dhënave të punëkërkuësve PAK, duhet specifikuar: llojin e aftësisë së kufizuar, moshën, gjininë, si dhe përgatitjen shkollore apo profesionale. Me këto të dhëna të konkretizuara, e përgatisim një raport dhe ia dërgojmë institucioneve relevante në Komunë, si gjetje të Komitetit.

- Mehreme Llumnica tha se HANDIKOS-i i ka këto të dhëna. Ajo pyeti se a ka diçka konkrete për çështjen e hapjes së Qendrës për Zhvillim dhe Karrierë. Ka PAK që ndoshta e gjejnë një pozitë në atë qendër.
- Premtime Preniqi tha se ligjet i kemi shumë të mira, siç është edhe ligji për PAK. Do të ishte mirë të respektohet vullnetarisht dhe pa imponime ajo dispozita 50 me 1. Mirëpo, jemi në një situatë jo të favorshme, në mungesë të vendeve të punës, kualifikimit etj.

- Mehreme Llumnica tha se anëtarët tanë shumë pak janë të informuar lidhur me ankesat. Ne duhet punuar për t'i informuar, nxitur dhe inkurajuar për të aplikuar dhe për tu ankuar, nëse është nevoja.
- Armend Ademi kërkoi të dijë se a ka mundësi kontakti si Komitet me KQZ, për të pare mundësinë që edhe PAK të kyçen në procesin zgjedhor. E për këtë, Mehreme Llumnica dhe Ramadan Salihu pohuan se një praktikë e tillë është duke ndodhur me shoqatat tjera dhe edhe Shoqata e të Shurdhërve mund t'i ketë monitoruesit e vetë nëpër pika të caktuara.
- Fatime Demolli **shtroi** nevojën për asistent ndihmës, siç e parasheh ligji, sepse, në kopshtin në të cilin ajo punon, e që është i vetmi kopsht që pranon fëmijë PAK, është e vetme si kuadër i specializuar dhe s'mund të përballet me gjithë ato nevoja dhe probleme.
- Mehreme Llumnica tha se Ligji për Arsim e parasheh vetëm mësuesin mbështetës. Në Planin e Veprimit e kemi ngritur këtë çështjen e punës së mësuesit mbështetës, sepse shpesh po ngatërrohet me asistentin personal.
- Fatime Demolli konsideron se mësuesi mbështetës është ai që mbështet krejt nxënësit e shkollës, ndërsa asistenti personal është ai që e paguan prindi i nxënësit PAK. Është hapur një klasë e nivelit të pestë të kualifikimit në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj. Edhe në Prishtinë është hapur një qendër e tillë. Por, a janë njoftuar PAK për këtë shkollë, në mënyrë që edhe ata të aplikojnë. Është njëvjeçare dhe pas kësaj mund të dalin asistentë personal.
- Ramadan Salihu përmendi dy çështje, për të cilat, në mënyrë të elaboruar u ka shkruar anëtarëve të Komitetit dhe zyrtarëve përgjegjës të Komunës, e ato janë: mundësia për vizita entiteteve homologe në rajon apo më gjerë dhe të sajohet lista e “miqve të Komitetit”. Këto dy iniciativa do të ndikonin pozitivisht në punën e Komitetit.
- Mehreme Llumnica në lidhje me këtë tha se duhet identifikuar në cilat vende mund të marrim eksperiencë. Mirëpo, asnjë vijë buxhetore nuk është e caktuar për vizita në kuadër të Komitetit. Nuk di se kush mund të na përkrahë. Ndërsa ajo propozoi që “Miqtë e Komitetit” të mos ftohen të gjithë në një takim, por një nga një. Pastaj, në takime të ftohen emra të fushave të ndryshme, që kanë eksperiencë të caktuara.
- Fatime Demolli, në lidhje me vizitën e **iniciuar**, tha se megjithatë, mund t'i drejtohem me një projekt Komunës, kompanive private, donatorëve ndërkombëtarë, etj.
- Premtime Preniqi tha se duhet mbajtur një mbledhje konsultative kah fundi i vitit, për ta bërë një plan për vitin e ardhshëm, si dhe raportin e vitit 2017 dhe të dyja këto duhet dorëzuar Kryetarit të Komunës. Ndoshta kishin për t'ju ndihmuar në disa pika edhe ekspertët komunal. Kur na është ofruar ndihmë për Komitetin nga KCFS, Drejtori i Administratës menjëherë ka pranuar. Pra, drejtori gjithnjë ka qenë në përkrahje. Nëse ju pajtoheni si Komitet, thirrni për ndihmë edhe “Miqtë e Komitetit”.
- Mehreme Llumnica është e mendimit që si grup të shkojmë tek Mevlude Zejnullahu – zyrtare në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në lidhje me hulumtimet për asistent personal, si dhe për mundësinë e një projekti për vizita. Në kompaninë e Ujësjiellit Rajonal “Prishtina” dhe në Kompaninë “Pastrimi”, kemi bërë hulumtime dhe nga atje rezultoi se nuk është asnjë PAK i punësuar, ndërsa, ka mbetur për të shkruar për informacione edhe në Ndërmarrjen Banësore.
- Fatime Demolli e pyeti Premtimen se a është e informuar cilat vende në rajon apo gjetiu e kanë të formuar Komitetin.

- Premtime Preniqi nuk pati informacion se cilat vende e kanë Komitetin, por mendon se një informacion i tillë mund të merret në Zyrën për Qeverisje të Mirë.
- Mehreme Llumnica tha se Zyra për Qeverisje të Mirë e ka Zyrën për Aftësinë e Kufizuar, por nuk e ka zyrtarin PAK. As Enti për Punësim nuk e ka të punësuar asnjë PAK.
- Gjatë gjithë këtij takimi, më së shumti u debatua për: çështjen e sigurimit të asistentit personal për nxënësit PAK nëpër shkolla, organizimin e vizitave hulumtuese dhe entiteteve homologe, si dhe praninë e “Miqëve të Komitetit” në mbledhje, të cilat ishin edhe konkluzione të kësaj mbledhje.

1.6. Mbledhja e gjashtë e Komitetit (13.12.2017)

Prezentë në mbledhjen e gjashtë të Komitetit ishin: Mehreme Llumnica – Kryesuese, anëtarë: Armend Ademi me interpret, Fatime Demolli, Ramadan Salihu dhe Enver Hasangjekaj, Shyhrete Islami – procesmbajtëse, dhe Premtime Preniqi – Zyrtare për të Drejtat e Njeriut. Rendi i Ditës, i propozuar dhe i miratuar për këtë mbledhje, ka për shqyrtim këto pika:

1. Miratimi i Ekstraktit të Procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit;
2. Puna dhe iniciativat e deritashme të Komitetit;
3. Shqyrtimi i Raportimit mbi Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prishtinës;
4. Të ndryshme.

Me miratimin e Ekstraktit të mbledhjes së pestë, u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës, që kishte të bënte me punën dhe iniciativat e deritashme të Komitetit, për çka kryesuesja, Mehreme Llumnica në formë të përmbledhur përmendi rezultatet e Komitetit gjatë periudhës nga mbledhja e fundit e gjer më sot, duke potencuar se ka qenë një kohë e dy palë zgjedhjeve, e cila në masë të madhe e ka tërhequr vëmendjen e opinionit dhe të politikës, me ç’rast, Komiteti nuk ka pasur hapsirë dhe me kë t’i realizojë objektivat e veta.

- Mehreme Llumnica tha se megjithatë, qoftë në emër të Komitetit, qoftë edhe me HANDIKOs-in çkado që mundet dhe kudo që mundet, flet apo bën diç për PAK. Në këtë kuptim, ajo ka marrë pjesë në takimin me Kryeministrin, me rastin e 3 Dhjetorit, si dhe ka marrë pjesë në nënshkrimin e një marrëveshjeje mes Trafikut Urban dhe të HANDIKOS-it, lidhur me lirin e PAK nga pagesa e biletës. Siç kanë thënë nga Trafiku Urban, ata kanë menduar se të gjithë PAK janë të asociuar në HANDIKOS, prandaj dhe vetëm Librezen e Anëtarësisë së HANDIKOS-it e kanë njohur si valide.
- Armend Ademi pyeti se, sipas asaj marrëveshjeje, a lirohen edhe të shurdhërit nga bileta.
- Mehreme Llumnica mendon se do të duhej që secila shoqatë ta lidhë një marrëveshje të tillë.
- Enver Hasangjekaj tha se fëmijët me autizëm nuk kanë librezë të shoqatës, prandaj, sipas kësaj logjike, ata privohen nga liri në trafik.
- Ramadan Salihu tha se për këtë çështje është folur e argumentuar edhe në mbledhjen e kaluar. Trafiku Urban nuk ka se pse të lidhë marrëveshje me shoqata për lirim nga pagesa, sepse liri nga pagesa është e drejtë ligjore, andaj nuk ka nevojë as Komiteti, as OJQ-të të bëjnë marrëveshje me Trafikun Urban e as me dikë tjetër, por vetëm duhet insistuar në zbatimin e ligjit. Asaj kompanie ndoshta i nevojitet ndonjë akt

udhëzues për këtë çështje apo edhe marrëveshje kompensimi me Komunën lidhur me transportin e PAK, por jo me shoqatat as Komitetin, që asnjëra s'ka se çka t'i ofrojë asaj ndërmarrje profitabile.

Shqyrtimi i Raportimit mbi Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prishtinës ishte pika e tretë e rendit të ditës, për të cilin raport kryesuesja e përgëzoi Ramadan Salihun që e ka hartuar, por i cili raportim duket pak sa i ashpër dhe, pasi që anëtarët e Komitetit e kanë pasur me kohë në lexim, mund ta japin kontributin e tyre.

- Enver Hasangjekaj nuk u pajtua me atë se raporti përmban tone të ashpra. Ai tha se e ka lexuar me vëmendje dhe sheh aty se autori e ka pasqyruar gjendjen reale rreth punësimit të PAK. Madje, ai potencoi se vetë situata e punësimit, përkatësisht, e mospunësimit të këtyre personave është e ashpër dhe alarmante.
 - Premtime Preniqi pajtohet me të cekurat në raport dhe është e mendimit se ky do t'i kontribuojë sensibilizimit të kësaj problematike.
 - Fatime Demolli tregoi se, pas shqetësimit të Ramadan Salihut që në aplikacione nuk figuron rubrika e aftësisë së kufizuar, ka marrë në sportel dy aplikacione të konkursit për mësimdhënës në Komunën e Prishtinës dhe në këto aplikacione figuron rubrika “A jeni Person me Aftësi të Kufizuar?”
 - Ramadan Salihu u përgjigj se ajo rubrikë ka munguar në aplikacionin e konkursit paraprak, por, në kontakt me Shefin e Personelit të Komunës, është parë se ky ka qenë një lëshim teknik. Ndërsa, sa i përket raportit, mbi bazën e të dhënave në të, pa u thelluar në përmbajtje, në Komunën e Prishtinës, prej 4398 të punësuarve, 15 prej tyre janë PAK, apo, shprehur në përqindje, vetëm 0.36%. Kjo mua më duket vërtetë alarmante dhe vërtetë duhet përmirësuar kjo gjendje.
 - Armend Ademi u interesua të dijë se a janë të punësuar dy interpretë në Shkollën Model dhe pse shoqata nuk ka informacion për ta. A mund që Komiteti të inkuadrohet dhe kjo të shkojë në koordinim me shoqatën në të ardhmen. Po ashtu, pyeti se a vlen për të gjithë punëdhënësit e edhe ata në sektorin privat ajo formula 50+1 për punësimin e PAK.
 - Ramadan Salihu u përgjigj se sipas Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e PAK, organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik, si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës, t'i punësojnë PAK dhe çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një PAK në çdo 50 punëtorë.
- Në pikën e fundit – Të ndryshme, kryesuesja theksoi aktivitetet me rastin e 3 Dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare të PAK dhe 10 Dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut. Tha se HANDIKOS-i e ka shënuar 3 Dhjetorin dhe përfaqësuesit e OJQ-ve kanë qenë në Kryeministri, në pritjen që Kryeministri Ramush Haradinaj ka organizuar për Forumin Nacional të Aftësisë së Kufizuar, me rastin e 3 Dhjetorit, ku ka marrë pjesë edhe ajo vetë, në të cilin takim, Kryeministri ka kërkuar të zbatohet legjislacioni për të drejtat e PAK, veçmas punësimi i tyre. Ajo shprehu keqardhje që Komiteti nuk ka organizuar shënimin e 3 Dhjetorit, por premtoi se në të ardhmen do të ketë aktivitete në kuadër të ditëve që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuar dhe të tjera.
- Premtime Preniqi dhe Ramadan Salihu gjithashtu pohuan se çdo shënim apo aktivitet i kontribuon sensibilizimit të çështjes së aftësisë së kufizuar.
 - Takimi i sotëm u përshkua kryesisht me Raportimin mbi Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prishtinës, si dhe me përcaktimin e detyrave për raportin vjetor të Komitetit, të cilat ishin edhe konkluzione të kësaj mbledhje.

2. TAKIMET

2.1. Takimi me Drejtorin e Administratës së Komunës së Prishtinës

Me Drejtorin e Administratës, z. Muhedin Nushi Komiteti ka pasur më shumë takime. Drejtori që nga mbledhja konstituive e Komitetit më 26.07.2016, në të cilën ka marrë pjesë, ka shprehur gatishmërinë që Komitetit t'i ofrojë bashkëpunim dhe përkrahje për funksionim sa më të mirë të tij, si dhe për realizimin e të gjitha të drejtave ligjore të PAK sa i përket domenit komunal të përgjegjësive në tërë territorin e Komunës së Prishtinës.

Komiteti ka çmuar në veçanti përkushtimin e z. Nushi për PAK, duke u shërbyer nga ai me informim, sygjerime e këshillime në aspektin legjislativ dhe procedural në përgjithësi në Komunën e Prishtinës.

2.2. Pjesëmarrja në inaugurimin e Liftit për PAK në Komunën e Prishtinës

Të pestë anëtarët e Komitetit kanë marrë pjesë në inaugurimin e Liftit për PAK dhe të platformës për qasje në atë lift në ndërtesën e vjetër të Komunës së Prishtinës, që ka ndodhur me datën 28 dhjetor 2016.

Realizimi i këtij projekti të kushtueshëm është konsideruar nga Komiteti si një investim i rëndësishëm për aftësinë e kufizuar, i cili ka impact të drejtpërdrejtë në qasjen më të lehtë të PAK me problem në ekstremitete në objektet e Komunës.

Këtë moment inaugurimi, anëtarët e Komitetit e kanë shfrytëzuar për t'i takuar edhe pjesëmarrësit tjerë në ceremoni, veçmas të PAK dhe të përfaqësuesve të tyre dhe marrjen e opinioneve të tyre për aspekte të ndryshme të problematicës së aftësisë së kufizuar.

2.3. Takimi me Drejtoreshën e Arsimit të Komunës së Prishtinës

Në Drejtorinë Komunale të Arsimit, më 28.12.2016, është mbajtur takimi me Drejtoreshën, znj. Arbërie Nagavci, në të cilin takim u diskutuan tema në fushëveprimin e kësaj drejtorie, lidhur me aftësinë e kufizuar, si:

- Situata aktuale e punësimit të PAK nëpër institucionet parashkollore, shkolla fillore dhe të mesme, për çka u konstatua se persona të tillë fatkeqësisht nuk ka apo ndoshta vetëm në një ose dy raste dhe se kjo situatë duhet të përmirësohet në proces.
- Ekipi Vlerësues në kuadër të Komunës së Prishtinës në prizmin e nxënësve me aftësi të kufizuara – U dakordua se duhet fuqizuar roli i atij ekipi, me qëllim që nxënësit me aftësi të kufizuara të kenë një trajtim adekuat dhe një perspektivë më të qartë shkollimi.
- Në momentin e pranimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Institucionin Parashkollor të lirohen pa procedura të mëtejme, konform UA 19.2016.
- Të shqyrtohet mundësia e punësimit të educatorëve mbështetës dhe mundësia e mbajtjes së punës në dy Institucione Parashkollore, ngjashëm me psikologët nëpër shkolla.

2.4. Takimi me Avokatin e Popullit

Në takim me z. Ilmi Jashari, Avokat i Popullit, të mbajtur më 10.03.2017, u shpalos roli i Komitetit, si dhe u diskutua çështja e punësimit të PAK në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Avokati premtoi që në të ardhmen do angazhohet që të pranohen PAK në pozitat përkatëse. Ai njoftoi se në vitin 2018, në institucionin e tij do të ketë këshilltarë për PAK.

2.5. Takimi me Drejtorin e Shërbimeve Publike

Më 20.01.2017, Komiteti ka pasur takim me Drejtorin e Shërbimeve Publike, z. Genc Begolli, në të cilin takim u fol për punën e deritashme të kësaj drejtorie sa i përket çështjes së PAK. Ndër të tjerash, këtu u fol edhe për:

- Qasjen dhe shfrytëzimin e Trafikut Urban nga PAK. dhe
- Shfrytëzimin e hapsirës publike të shesheve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme nga OJQ.

2.6. Takim me Menaxherin e Burimeve Njerëzore

Komiteti ka zhvilluar edhe një takim me Menaxherin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, z. Avni Zuka, më 11.05.2017, me ç'rast u diskutua çështja e punësimit të PAK në Komunën e Prishtinës. Në këtë takim, menaxheri mori për sipër që në aplikacionet e konkurseve të Komunës të jetë një rubrikë e veçantë, në të cilën do të shkruhet "*Jeni Person me Aftësi të Kufizuara*". Në këtë mënyrë do jetë më lehtë identifikimi i PAK dhe marrja e masave afirmative për punësimin e tyre në kushte të barabarta.

2.7. Takimi me Zyrtaren nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm

Znj. Mevlude Zejnullahu – Zyrtare nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e ka informuar Komitetin, në takimin e mbajtur më 12.10.2017, mbi hapat e kësaj zyre për përfshirjen e PAK në riaftësim profesional në Qendër të Karrierës, si dhe punësimin e PAK në bizneset e vogla, duke u ofruar lehtësira atyre që punësojnë PAK.

(III)

PJESA PËRMBYLLËSE

PËRFUNDIMI ME REKOMANDIME

Ky raport është i pari që sublimon punën dhe aktivitetet e Komitetit për një periudhë njëvjeçare, i cili përfshin edhe disa aktivitete nga viti paraprak. Si i tillë dhe me qëllim të njoftimit më të gjerë të komunitetit të aftësisë së kufizuar në Komunën e Prishtinës, janë përshkruar detaje të hollësishme dhe konkrete lidhur me diskutimet dhe debatet në mbledhje.

Sipas raportit vërehet se problemet e PAK në Komunën e Prishtinës janë të shumta dhe ato presin zgjidhje. Veçmas, në të gjitha mbledhjet dhe takimet, vëmendje e veçantë i është dhënë punësimit të PAK, temë kjo në vete, e cila i preokupon më së shumti PAK dhe pret zgjidhje më të shpejtë.

Gjithashtu, Komiteti vëren se institucionet komunale të Prishtinës kanë një gatishmëri në rritje për t'i përbushur obligimet ligjore për PAK, përfshirë edhe atë të punësimit, por potencojnë se kanë kufizime ligjore dhe buxhetore në këtë aspekt.

Bazuar në gjendjen reale dhe të mundësive që pasqyrohen edhe në këtë raport, Komiteti nxjerr edhe këto rekomandime:

- Legjislacioni që ka të bëjë me të drejtat e PAK është mjaft gjithpërfshirës dhe len hapsirë për gjithpërfshirje, si dhe për të drejtat tjera të PAK, në mënyrë specifike për punësimin e tyre, vetëm don interpretim të saktë të atij legjislacioni dhe vullnet para së gjithash.
- Në aktet normative të Komunës së Prishtinës, sipas paragrafit 1 të nenit 31 të Statutit, ka mundësi të bëhet ndryshimi i dispozitës së nenit 59.4 të atij Statuti, ku thuhet: “Secila drejtori duhet të përpiqet të sigurojë balancën në barazinë gjinore, në të gjitha fushat dhe nivelet në Shërbimin civil komunal.” në formën: “Secila drejtori dhe ndërmarrje publike duhet të sigurojë balancën në barazinë gjinore dhe të pjesëve të marginalizuara të shoqërisë, në të gjitha fushat dhe nivelet në Shërbimin Civil Komunal”.